

**Miratohet  
Leonard SOLIS  
Ministri i Shendetesise  
Kryetar i KMR**

**MINISTRIA E SHENDETSISE  
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET**

**KODI I PRAKTIKES NE RADIOTERAPI**

**Nr.804/1prot**

**Date 15.03.2005**

## Hyrje

**Kodi i praktikes** i repartit te radioterapise, sherben si udherrefyes per organizimin e punes, detyrat e personelit, dhe kryerjen e procedurave te rrezitjes se pacienteve, konform te dhenave me te fundit te shkences, ne menyre qe rrezitja te jete sa me efikase, e ne te njejten kohe te siguroje nje mbrojtje sa me te pershtateshme per punonjesit e per vete patientet.

Dispozitat e ketij Kodi praktit jane ne perputhje me ligjin dhe rregulloret per Mbrojtjen nga rrezatimet.

Permbajtja e Kodit duhet te njihet e te pervetesohet nga personeli i njesive radioterapeuike dhe eshte i detyrueshem per tu zbatuar prej tyre.

### I. Dispozita te pergjitheshme

Repartet e **radioterapise** jane **njesi berthamore**, qe merren me perdonimin e **rrezatimeve jonizuese** e te **lendeve radioaktive**, per qellime **mjekimi**. Pjese perberese e tij, jane edhe paisjet diagnostikuese e ato lokalizuese te lezioneve, qe jane ne sherbim te mjekimit. Repartet e **radioterapise**, perbejne sherbime me karakteristika te vecanta, brenda sherbimit te onkologjise. Ne repartet e radioterapise patientet trajtohen nepermjet:

- a) teleterapise, dhe**
- b) brakiterapise (terapise se kontaktit)**

Ne **teleterapi** bejne pjese metodat e paisjet, qe i rrezatojne patientet nga jashte; pra, ne te cilat burimi i rrezitjes, ndodhet jashte patientit. Teleterapia kryhet nepermjet:

- a) kobaltoterapise, dhe**
- b) rentgenterapia .**

Ne **brakiterapi**, bejne pjese metodat e paisjet, qe i rrezatojne patientet nga brenda, ku burimi i rrezitjes ndodhet brenda patientit. **Brakiterapia** ndahet ne:

- a) brakiterapine intrakavitare, dhe**
- b) brakiterapine intersticiale**

### II. Kërkesat per trajtimin e pacienteve.

Trajtimi i semundjeve onkologjike me rrezatime jonizuese eshte detyra themelore e cdo reparti te radioterapise. Perdonimi i rrezatimeve jonizuese, si mjet mjekues kerkon qe te merren nje seri masash sakteuses kliniko-dozimetrike, per te arritur efikasitetin maksimal, perpara fillimit te trajtimit te pacienteve.

Trajtimi i te semureve duhet te behet detyrimisht pas trajtimit “paraprak”, ose sic quhet ndryshe, pas trajtimit “ne leter”, pra pas perzgjedhjes se kushteve optimale te trajtimit ne menyre paraprake. Per trajtimin “paraprak” shfrytezohen nga stafi i reparteve programe dhe praktika qe bejne te mundur zgjedhjen e kushteve sa me optimale te rrezatimit.

Rendesi te posacme ne trajtimin e pacienteve, ka njohja e sakte e karakteristikave te tufes se rrezatimit, si mjeti me te cilin behet mjekimi.

Keto karakteristika mund te ndahen ne:

- a) fizike,**

**b) biologjike, dhe**

**c) gjeometrike**

te cilat eshte e domosdoshme te njihen me saktesi, per te kryer nje trajtim sa me efikas.

Per semundjet onkologjike te thella, numri dhe saktesia e te dhenave, duhet te jene me te medha, si per semundjen ashtu edhe per rrezatimin. Kjo presupozon simulimin e rrezatimit ne simulator, nga njera ane, dhe dozimetrim te sakte nga ana tjeter.

Ne rastin e teleterapise, fraksionimi i dozes kerkon nivel te larte te saktesise ne perseritshmerine e kushteve te rrezatimit.

Per teleterapine (rentgenterapine) e semundjeve siperfaqesore apo gjysem siperfaqesore, rendesi te dores se pare ka njohja dhe percaktimi i sakte i thellesise se lezionit, njohja po kaq e sakte e cilesive fizike te tufes se rrezatimit, dhe perseritshmeria e rrezitjes. Ne te gjithe rastet (ku ne vecanti hyn edhe brakiterapia), rendesi te madhe ka njohja a programeve kompjuterike te trajtimit dhe perdonimi i sakte i tyre.

### **III. Kerkesat per personelin.**

Personeli i reparteve te radioterapise perbehet nga: mjeket radioterapeute, fizikantet, laborantet dhe sanitaret.

Sanitaret duhet te instruktohen dhe te kene njohurite elementare per mbrojtjen nga rrezatimet, per te shmangur cdo lloj avarie gjate punes se tyre. Kjo gje vlen te theksohet ne menyre te vecante per brakiterapine, ku mundesite e demtimit nga burimet rrezatuese jane me te medha.

Laborantet duhet te kene detyrimisht arsimin e mesem si dhe arsim profesional per rrezatimet. Dijet e tyre duhet te sigurojne trajtimin e sakte te poatientit dhe njohjen e rreziqeve qe vijne nga perdonimi i parregullt i rrezatimeve si per pacientet ashtu edhe per ta.

Laborantet e reparteve te brakiterapise, pervec kerkesave te mesiperme, duhet te kene edhe arsim infermieristik.

Mjeket e reparteve radioterapeutike jane mjeke specialiste qe kane kaluar specializimii perkates dhe te njohin elementet e fizikes se rrezatimeve, te demtimeve prej tyre, te dozimetrise, si dhe te mjekesise se specialitetit.

Fizikanet vec aresimit perkates duhet te njohin elemente te anatomise, te onkologjise etj. si dhe te kene kualifikimin e nevojshem per dozimetrine e fiziken se rrezatimeve

Per te gjithe kategorite e punonjesve te rrezatimit, duhet te parashikohet mundesia e kualifikimit te certifikuar, si dhe riperteritja e periodike e njohurive, e shoqeruar me rinvim te detyruar te certifikimit sipas kerkesave ne fuqi si per te kontrolluar dijet ekzistuese ashtu dhe per te shtuar e plotesuar ata me dije te reja.

Personeli duhet t'i nenshtrohet pjesemarrjes aktive ne veprimtari trainuese per ngritjen e vazhdueshme e te organizuar profesionale, ne te gjithe nivelet.

Personat qe kerkojne te pranohen ne pune ne repartet e radioterapise duhet t'i nenshtrohen kontrollit mjekesor paraprak. Personelit i sigurohet gjithashtu kontroll periodik mjekesor.

Personelit i sigurohet monitorim i vazhdueshem dozimetrik personal, si dhe dozimetria e vendit te punes. Ne rast tejkalimi te dozave kufi, merren masa me karakter mbrojtës, ne perputhje me rregullat ne fuqi.

## IV. Kerkesat per mjediset

Duke qene njesi berthamore, mjediset e reparteve te radioterapis, ndahen ne:

**a) zona te kontrolluara, dhe**

**b) zona te mbikqyrura.**

**Zone e kontrolluar** eshte zona ne e cilen jane vendosur dhe punojne pajisjet rrezatuese Ne kete ndalohet hyrja dhe qendrimi i personave qe nuk kane lidhje me punen ne repart.

**Zona e mbikqyrur** perbehet nga mjediset e tjera qe jane fqinje me zonen e kontrolluar.

Ne zonen e kontrolluar behen matje sistematike te niveleve te rrezatimeve, te shperndarjes se dozave, duke treguar dhe afishuar vlerat qe ato kane ne vendet e punes se personelit. Ne hyrjet e zonave te kontrolluara vendoset shenja e rrezikur radioaktiv.

Ne zonat e kontrolluar nuk lejohet kryerja e asnje veprimtarie, qe nuk kane lidhje me rrezatimin.

Ne zonat e mbikqyrura, duhet te merren masa per sigurimin e nje mbrojtja te mire nga rrezatimet nepermjet matjeve periodike te niveleve te rrezatimeve.

## V. Detyrat e personelit

### V.I. Detyrat e shefit te repartit

- Te organizoje punen administrative dhe mjekuese ne repartin e radioterapise.
- Te **organizoje,te bashkerendoje e te drejoje** punen kolegjiale te stafit **mjek-fizikan-laborant**, per trajtimin sa me te mire te pacienteve.
- Te organizoje punen me stafin mjekesor te repartit si dhe te koordinoje punen me mjeke te reparteve te tjere,per percaktimin e taktikes se mjekimit te pacienteve.
- Te drejoje punen **per hartimin, ndryshimin e zbatimin** me perpikmeri, **te protokolleve te trajtimit**.
- Te organizoje,ne menyre periodike,diskutime te rasteve te vecante te komplikuar, ku te terheqe ne menyre shkencore mendimin e perparuar te specialisteve.
- Te ushtroje kontolle periodike e te befasishme,te punes se laboranteve,vetem ose bashke me koleget e tjere.
- Ne punen administrative,te siguroje te gjithe nevojat e repartit ne bashkepunim me drejtorine.
- Te siguroje mbarevajtjen e punes se repartit duke siguruar **integritetin e tij**,vecimin nga mjediset e tjera qe nuk punojne me lende radioakteive e burime rrezatimesh jonizuese.
- Te siguroje kushtet e paisjet per mbrojtjen e punonjesve te repartit nga rrezatimet jonizuese konform ligjit.
- Te kerkoste ne rruge administrative **zbatimin e ligjeve** ne fuqi **per te drejtat dhe detyrimet** qe kane punonjesit e repartit,ne menyre qe te siguroje,perdorimin sa me efikas te rrezatimeve per qellime mjekimi.
- Te perpiqet te hartoje, bashke me koleget, programe, aktivite e shkembime mendimesh e eksperiencash, qe cojne ne ngritjen e vazhdueshme **te nivelit profesionale** te punonjesve te repartit
- Te siguroje perdorimin e teknikave e metodikave **bashkekohore** te trajtimit te pacienteve.

- Te kombinoje e te siguroje kontakte me klinika e reparte te ngjashem te vendeve te tjera, e te sjelle ne praktikat e perditeshme te repartit, metodika te reja prej tyre.
- Te kerkoste e te siguroje qe **te rejat shkencore** te fituara nga punonjesit e repartit nepermjet trajnimeve, konferencave, takimeve e studimeve te vecanta, te per gjithesohen, duke u vene **ne sherbim te trajtimit** sa me te mire te pacienteve.

## V.2. Detyrat e mjekeve

- Te njojin mire karakteristikat dhe elementet kryesore te fizikes se rrezeve,sic jane:menyra e prodhimit,energjia,fuqia e dozes,aftesa depertuese,mekanizmat e veprimit qe shkaktojne demtimet biologjike si dhe ata mbi te cilet eshte bazuar veprimi mjekues i rrezatimeve jonizuese,etj.
- Per kete qellim,mjeket qe merren ne pune per here te pare te kalojne nje program te fizikes se rrezeve,te dozimetrise te demtimeve biologjike,kurse mjeket qe jane ne pune t'i nenshtrohen rinoximit e rifreskimit te dijeve,nepermjet trainimeve te organizuar ne raste kur futet ne perdonim nje aparature apo/dhe metode e re ,si dhe te trainimeve periodike.
- Te njojin mire onkologjine e per gjitheshme,radioterapine dhe te gjithe derivatet e tyre,qe lidhen me trajtimin radioterapeutik te semundjeve onkologjike.
- Te marrin pjese aktive ne formulimin e modifikimin e protokoleve te radioterapise,si dhe ne zbatimin e tyre te sakte.
- Ne bashkepunim me fizikanet,te vendosin per trajtimin e pacienteve,pasi te kene mbledhur informacionin e duhur nga hallkat diagnostikuese,per tipin, vendndodhjen, madhesine, kufizimin e lezionit etj.,duke zgjedhur llojin e rrezatimit,menyren e rrezitjes etj.
- Te dokumentojne mire e qarte ne kartelat klinike,te dhenat per historine e per karakteristikat e semundjes e te lezionit,si dhe ne kartelat e rrezatimit,kushtet e rrezitjes te percakuara nga fizikanet.
- Te ndjekin patientet,ne dinamike,per ecurine e rrezitjes e te ndryshimeve (reduktimit,reaksioneve,etj.)te lezioni,nga veprimi i rrezatimeve jonizuese.
- Ne rast te ndryshimeve te theksuara, te modifikojne terapine rrezatuese,ne bashkepunim me fizikanet, duke ja pershtatur ate kushteve te reja(permasave te reja etj.),per te patur efikasitet maksimal te trajtimit.
- Ne asnje rast dhe per asnje arsyet,te mos vendosin paciente ne rrezatim pa marre mendimin e fizikaneve per llojin sasine e menyren e rrezitjes.
- Per terapine e thelle(aktualisht,kobalto-terapine e ne ndonje rast ro-terapine e thelle),te percaktohet prej tij volumi qe duhet rrezatuuar(target volume),e organet fqinje me te qe duhen mbrojtur,e pastaj te miratohet ne bashkepunim me fizikanet,versioni perfundimtar i trajtimit.
- Per rentgenterapine siperfaqesore, si dhe ate gjysem te thelle, te vendose se bashku me fizikanet, per aplikatorin, energjine e rrezatimit, kohezgjatjen e tij etj., qe duhen perdonur per cdo rast.
- Per brakiterapine, bashkepunimi me fizikanet duhet te jete me i ngushte; ai duhet te filloje ne diskutimin e lokalizimit e te shtrirjes se lezionit, ne percaktimin e gjeometrise, kohezgjatjes se rrezatimit etj.

-Cdo vendim i njeanshem i mjekeve, per te realizuar terapine pa konsultimin me fizikanet, mund te coje ne pasoja te padeshirueshme, e per pasoje eshte kategorikisht i ndaluar.

-Te njohin parimet baze te mbrojtjes nga rrezatimet,per te mbrojtur vehten,e per te kontribuar ne mbrojtjen e te tjereve

-Te ndihmojne per mbajtjen e rregullit ne mjediset e punes, duke mos lejuar ne to, persona qe nuk kane lidhje pune me rrezatimet.

### V.3.Detyrat e fizikaneve

- Meqenese mjeti qe perdoret ne radioterapi, per mjekimin e semundjeve onkologjike, jane rrezatimet jonizuese, te cilat krahas te mirave paraqesin edhe rrezikshmeri, detyrat e fizikaneve, te cilet jane me prane njohjes se vetic fizike te rrezatimeve, eshte paresore e themelore si ne mjekimin e pacienteve, ashtu edhe ne mbrojtjen e personelit e te vete pacienteve.

- Fizikanet duhet te njohin mire vetic fizike kryesore te te gjithe llojeve te rrezatimeve qe perdoren ne repart, bashkeveprimin e tyre me lendet inorganike e ato organike,dhe percaktimin e shkalles se ketij bashkeveprimi.

- Te njohin mire funksionimin e perdonimin e aparaturave te rrezatimeve jonizuese e te lendeve radioakteve qe perdoren ne repart.

- Te bejne **kalibrimin** e tyre ne menyre periodike sakte e ne perputhje me kerkesat e kohes.

- Te bejne,ne menyre periodike matjen e **kontrollit te cilesise** se rrezatimit (**Quality Control**), ne te gjithe aparatet e rrezatimeve

- Te bejne matjet e **sigurise se cilesise(Quality Assurance)**, ne menyre periodike per te gjithe aparatet.

- Te njohin mire aparatet mates te rrezatimit, sic jane dozimetrat, survejmetrat, dozimetrat individuale, alarm-monitoret e te tjera paisje, qe sherbejne per zbulimin (detektimin), matjen e cilesise e te sasise se rrezatimit, si dhe te gjithe paisjet e tjera te kesaj natyre.

- Ne menyre te posacme te realizojne matjet e fuqise se dozes e te cilesise se rrezatimeve, ne menyre periodike, per ti dhene doza te pershtateshme e te sakta pacienteve, pasi prej kesaj varet mbarevajtja e mjekimit me radioterapi.

- Te verifikojne,ne menyre periodike, perputhjen e tufes luminoze me ate rrezatuese ne aparatet e teleterapise, e ate te perputhjes se pozicionit te burimeve me fundin e `folese` se vektoreve ne aparatin e brakiterapise, per te sakesuar me mire `pozicionin hapsinor` te tufes se rrezatimit.

- Te njohin mire algoritmet e programeve kompjuterike per trajtimin e pacienteve(Treatment Planning).

- Te njohin mire perberjen fiziko-kimike te organeve e indeve te organizmit te njeriut, vendndodhjen e tyre relative kundrejt njeri -tjetrit,etj., per te realizuar nje gjeometri sa me te sakte, per trajtimin efikas te pacienteve.

- Te njohin vecorite kryesore biologjike te indeve e organeve, per te njohur shkallen e radiosensibilitetit te tyre, ne menyre qe te mbrohen ata sa te jete e mundur, pa prishur cilesine e trajtimit.

- Te bejne dozimetrine e mjedisit te punes, duke percaktuar pikat e `nxehta`. Te mundohen me masa mbrojtese te zhdukin pikat e nxehta, e ne pamundesi, t'i tregojne ato ne menyre te dukeshme per te mbrojtur punonjesit.
- Te organizojne mbrojtjen e punonjesve e te pacienteve. Mbrojtja e punonjesve, behet konform ligjit ne fuqi duke patur ne themel te saj parimin ALARA. Mbrojtja e pacienteve ka ne themel te saj `dhenien e dozave sa me te sakta e ne te njeften kohe, evitimin ne maksimum te rrezatimeve te panevojshme per ta.
- Te ndergjegjesojne punonjesit per nevojen e dozimetrisse personale dhe t'i detyroje ata qe te mbajne dozimetrat.
- Te organizojne e te realizojne ngritjen profesionale te personelit te mesem e atij te larte mjekesor, per problemet qe lidhen me perdonimin sa me efikas te rrezatimeve dhe per probleme qe lidhen me mbrojtjen.
- Sebashku me mjeket, te percaktojne kushtet optimale fiziko-mjekesore te trajtimit te pacienteve, si dhe te realizojne trajtimin `paraprak` per patientet.
- Te per gjigjen, ne aspektin e mbrojtjes, per cdo ndryshim ne ndertimin e mjediseve, duke llogaritur muret, barierat etj., masa mbrojtese te pershtateshme per mbrojtjen e punonjesve e te pacienteve.

#### **V.4. Detyrat e kryelaborantit**

- Te sherbeje si hallke ndermjetese midis laboranteve e stafit fizikan-mjek, ne te gjitha ceshtjet qe kane te bejne me mbarevajtjen e trajtimit te te semureve.
- Te organizoje e te kontrolloje `turnet`, te cilet per realizimin e nje pune me cilesore, duhet te jene te perbere nga dy vete.
- Ne cdo fillim jave duhet te beje kontrollin e paisjeve e parametrave te aparateve, sic jane funksionimi i griles, paisjeve mbajtese etj., te kobaltit, tubusat, gomat mbrojtese etj., te aparatit(aparateve),te rentgenterapise,etj.
- Te interesohet per qetesine dhe rregullin ne repart, sidomos ne moslejimin e hyrjes se personave te papune.
- Sebashku me mjekun te organizoje kontolle te punes se laboranteve.
- Te mbaje evidenca te qarta per trajtimet e kryera ne repart.
- Te organizoje punen e mbajtes se pastertise e te regullit ne repart.
- Te bashkerendoje punen e hallkave te ndryshme te repartit, sidomos ne drejtim te plotesimit, nga ana e prapavijes, te nevojave te repartit.
- Te siguroje materialet ndihmese per repartin, sic jane materialet e buta, paisjet per pastrimin e plageve etj., qe nevoiten gjate punes me rrezet.
- Te jete jo vetem shembull ne punen e perditeshme me patientet, por dhe iniciator i futjes se teknikave te perparuara, nepermjet frekuentimit te te gjitha formave te mundeshme te organizuara per kete qellim ne repart.

#### **V.5. Detyrat e laboranteve**

##### **V.5.1. Detyra te per gjitheshme**

- Te mirembaje mjedisin e punes,brenda dhomes se rrezatimit dhe jashte saj dhe ne tabelen e komandes.Te kontrolloje gjendjen e per gjitheshme te aparatit para fillimit te punes dhe pas mbarimit te punes. Te kontrolloje temperaturen e mjedisit ku behet aplikimi dhe te mos filloje punen ne se ajo nuk eshte mbi vlera te pranueshme per pacientin dhe per aparatin.Te trajtoje me saktesi pacientin sipas te dhenave te shenuara ne kartele.

- Te ndjeke me vemannje pacientin gjate trajtimit dhe te nderhyje ne se verren dicka jo te rregullt. Te mos lejoje asnjeri, qe nuk ka lidhje me punen ne vendin e punes. Te dorezoje turni ne rregull, duke treguar qe mjedisi dhe aparati jane ne gjendje pune. Per cdo difekt apo mangesi qe veren ne kartele, aparat etj., te njoftoje menjehere kryelaborantin, fizikanet, apo mjekun. Laboranti mban per gjegjesi te plote per cdo gje qe lidhet me mbarevajtjen e mjekimit, respektimin e skemes se trajtimit, rregullin dhe shhangjen e avarive ne aparat etj. Ne rast te shuarjes se shenjave te piketimit, te ndonje reaksioni etj., ai njofton menjehere mjekun. Me qellim te kryerjes sa me me cilesi te trajtimit, si dhe per shkurtimin e kohezgjatjes se qendrimit ne bunker, `turnet` e punes se laboranteve duhet te perbehen nga dy vete. Ndalohet puna vetem me nje person ne te gjithe aparatet. Me qellim pervesimin sa me te mire te teknikes ne nje lloj pune, laborantet do te punojne ne aparat te caktuar pa bere qarkullim.Gjate kohes se fillimit te punes e deri ne mbarim te saj, laborantet, ashtu si dhe te gjithe punonjesit e njesise, duhet te mbajne ne bluzat e tyre, dozimetrat personale, dhe mjete te tjera mbrojtese qe u jepen atyre ne perdonim.

### **V.5.2. Detyra te vecanta te laboranteve**

- Krahas detyrave te per gjitheshme,per kryerjen me saktesi te punes se tij,laborantet zoterojne njohuri e kryejne detyra specifike sipas vendit te punes, prej te cilave me te rendesishmet jane renditur me poshte.

#### **a) ne telekobaltoterapi.**

- Te kontrolloje sinjalet e tablees se komandes,semaforet ne deren e labirintit etj.,para se te hyje ne bunker,per te qene i sigurte qe burimi gjendet ne pozicionin `OFF`,pra ne gjendje `qetesie`,per te shhangur,keshtu,eksposozimin e tij aksidental.Ne qofte se ndonjeri prej ketyre sinjaleve nuk funksionon,nderpritet puna menjehere e njoftohet kryelaboranti fizikanti e shefi i repartit.

- Te kontrolloje lazerat,kendet,distançat etj.,ne aparatin e kobaltit,per te shhangur cdo lloj trajtimi te gabuar te pacientit.Per cdo shhangje nga norma apo mosfunksionim te rregullt te tyre,te njoftohen personat per gjegjes,duke filluar nga kryelaboranti.

- Te zbatohen me saktesi kushtet e percaktuara ne trajtimin `paraprak`nga fizikani dhe mjeku ne kartele, cdo dite, gjate vendosjes se pacientit ne rreze.

- Te mbahen ne rregull e me saktesi shenimet ne kartele per dozat e dhena e per ndryshimet e tyre nga mjeku e fizikani.

- Te ndiqet me kujdes cdo ndryshim i mases tumorale (kur kjo eshte e mundur),ne madhesi,reaksioni etj., e te njoftohet, per kete, mjeku.

#### **b) ne rentgenerapi**

- Te behet kujdes ne ndjekjen me perpikmeri te rregullave te venies ne pune te aparatit.Ne se per arsyte rrimes,presionit,temperatures etj.(ndiq me kujdes njoftimin ne ekranin e vogel te tablese se komandes),aparati nuk rrezaton ose nderpret rrezatimin, fillimisht prit rreth 10 minuta para se t'a riprovosh,e pastaj njoftohet menjehere fizikani.
- Kontrollo temperaturen e dhomes,e ne se eshte jashte diapazonit te lejuar(20-25 grade celsius)mos fillo rrezatimin.
- Njihu mire me te dhenat e karteles,per tensionin,filtrin tubusin etj.,parametra,ne menyre qe te mos i ngaterrosh ata.Cdo ngaterrese e ketille mund t'i kushtoje shume pacientit.
- Asnjehere mos fillo punen(mos tento te fillosh punen),pa bere `operacionin` e nxemjes(Warm up)duke vendosur per kete qellim filtrin perkates.
- Meqenese aparati i rontgen-terapise i perketoj fjalet se fundit te teknikes,para se te vihet ne pune,cdo dite,duhet te ndiqen me saktesi te dhenat e instruksionit.Mos zbatimi,qofte edhe i nje hapi te vetem te instruksionit,mund te coje ne difekt te aparatit.

### **c) ne brakiterapi**

- Te njohe specifiken e punes ne brakiterapi,e cila,duke qene terapi intrakavitare,pra duke qene se burimet e rrezatimit futen brenda trupit te pacientit,kerkon njojje te vecanta te paisjeve e te shperndarjes se dozave ne brendesi te tij.
- Te njobin proceduren e zbatimit me saktesi te metodes after-loading te trajtimit te lezonave tumorale(aktualisht behet vetem trajtimi i kancerit te qafes se mitres).
- Te kene njoburi te mjaftueshme per cesiumin radioaktiv(Cs-137),karakteristikat e tij kryesore,dhe te njobin mire aktivitetin,formen dhe shperndarjen e dozes ne afersi te burimeve qe posedohen ne paisjen gjysem automatike AMRA,te futjes(inserimit)se tyre ne brendesi te pacientit.
- Te njobin mire ndertimin dhe funksionimin e paisjeve(kyritronit) me ane te te ciles futet lenda radioaktive ne brendesi te pacientit.Proceduren e futjes se lendes radioaktive, ta zoterojne mire per te realizuar futje sa me te shpejte e te sakte.
- Te perdonin mire kohe-matesin(tajmerin) e paisjes, ne menyre qe ne rast nevoje te dine te nxjerrin e pastaj te fusin serisht burimet radioaktive ne brendesi te pacientit, pa ndryshuar kohen totale te trajtimit, te llogaritur nga fizikanet.
- Duke njobur vetite kryesore te cesiumit-137, si dhe duke patur instruktazhin perkates, te dine te mbrohen nga rrezatimi duke perdonur paravanet e levizshem, largesite e pershtateshme etj.
- Gjate aplikimeve mjekesore si injeksione, matje tensioni, dhenie ndihme te shpejte, etj.,qe jane veprime te pashmangeshme e te domosdoshme per pacientin, te manovroje me shkathesi e shpejtesi, duke ulur sa te jete e mundur koheqendrimin prane pacientit, duke shfrytezuar mjetet mbrojtese te levizeshme.
- Te instruktohen per shperndarjen e rrezatimit jashte pacientit, duke ditur drejtimin e perhapjes me te madhe(qe jane hapesira ndermjet dy kembeve,e prerja terthore ne nivelin e qafes se mitres), si dhe vlerat e peraferta te dozes ne keto drejtime.
- Te ndjekin me kujdes proceduren e perqatitjes se futjes se vektoreve dhe gjate transportimit te pacienteve per nga aparati i grafise, apo gjate levizjeve te tjera, te kene parasysh mundesine e levizjes se vektorit, e ta shmangin ate sa te jete e mundur.
- Te mos lejojne ne asnje rast e per asnje arsyte qendrimin e familjareve e te personave te tjere ne brendesi te repartit.

## V.6. Detyrat e sanitareve

- Te pastrojne mjediset dhe aparatet, te pakten dy here ne dite. Pastrimi ne kabinetet e rrezatimit duhet bere per te eliminuar pluhurat, si ne dysheme, ne dyert dhe ne objektet e tjera brenda tij. Pastrimi behet gjithmone kur aparati nuk eshte duke punuar . Sanitaret duhet te jene te pajosura me dozimetra personale. Ato duhet te njojin elementet e mbrojtjes nga rrezatimi, nepermjet instruktimit fillestar dhe nepermjet instruktiveve periodike.

### **-Detyrat specifike per sanitaret ne brakiterapi**

- Te kujdesen qe gjate pastrimit te mos lere pluhura ne pergjithesi ,e ne dhomen e aplikimit e ate te pacientit ne vecanti.
- Pas cdo levizjeje , per arsye pune, te sistemit te levizshem te mbrojtjes(paravane, aplikatoreetj), se bashku me infermieret-laborante, ti rivendose ata ne vendet e pershtatshme per mbrojtje.

## VII. Kërkesa permbyllse

- Te gjithe qytetaret gezojne te drejten e mjekimit dhe sipas ligjit per mbrojtjen ata gezojne te drejten per te qene te mbrojtur nga rrezatimet jonizuese

- E zberthyer per rastin radioterapise, kjo e drejte nenkupton, ne rradhe te pare qe pacientet qe kane nevoje per trajtim me rrezatime jonizuese, duhet te kene per kete, indikacion absolut. Kjo do te thote qe ndalohet kategorikisht dhe eshte ne kundershtim te plote me etiken mjekesore perdonimi i rrezatimeve jonizuese, pa patur per kete indikacion te plote e jetesor.

- Perdonimi, ne rast te kundert, i rrezatimeve jonizuese, pa qene nevoja apo/dhe kur kjo nevoje nuk lidhet me mjekimin e semundjeve te tilla te rrezikeshme sic jane ata onkologjike, perben nje shkelje flagrante te te drejtave qytetare, qe mund te sjellin demtime te pakorrigjueshme shendetesore per ta.

- Nga ana tjeter, eshte **detyre humane**, dhenia e ndihmes se kualifikuar mjekesore rrezatuese pacienteve qe vuajne nga semundje onkologjike, per te ndihmuar me te gjitha menyrat **per sherimin apo dhe permiresimin e tyre**.

- Ne kete kontekst per pacientet zbatohet parimi i justifikimit dhe optimizimit por jo i kufizimit te dozave.

- Kjo gje obligon punonjesit e ketyre njesive berthamore, te jene te perzgjedhur,e te perzgjedhin nga vetehtja cilesite me te mira **humane e intelektuale** per te perdonur me efikasitet `**armen` e rrezatimit ne te mire te njerezve**.

Ne permbyllje, duhet theksuar e nenvizuar, se **profesioni i radioterapise** duhet konsideruar si nje **mision human**, qe kerkon, vec te tjerash, **nje nivel te larte profesional te punonjesve**.